



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 17.1. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

**PROCESVERBAL**

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe  
Mbiqëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

**Në mbledhje morën pjesë:** Daut Haradaj, Ganimete Musliu, zëvendëskryetare e parë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Fatmir Shurdhaj, Qerim Bajrami, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha, anëtarë.

**Mungoi:** Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dhurata kryeziu- OSBE; Senton Kaçaniku-IEA Corporation; Leonora Berkani- ICITAP; Luanda Domi-DCAF; Rroksana Qarri-Ministria e Punëve të Brendshme; Vlora Nushi-UNMIK dhe Agnesa Haxhiu-KDI.

**Nga Stafi mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

*Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

## Diskutim rreth situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës.

**Kryetari**, fillimisht uroi anëtarët për sesionin pranveror dhe falënderoi për prezencën e ministrit të Punëve të Brendshme në Komision, për shkak të rrethanave të krijuara në veri të vendit, ku forcat e Policisë së Kosovës, kanë ndaluar trenin ilegal, duke kryer detyrat sipas Kushtetutës. Gjithashtu, përgëzoi veprimet e ndërmarra nga ana e Policisë së Kosovës dhe ofroi mbështetjen e Komisionit. Më tej, fjalën ia dha z. Skënder Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

**Ministri i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni**, fillimisht theksoi se që nga dita e paralajmërimit që do të ishte një tren me ikonografi dhe mesazhe nacionaliste, që do të provokonin qytetarët e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme ka qenë në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës, duke i trajtuar opsionet më të arsyeshme, me qëllim të respektimit të Kushtetutës dhe evitimit të incidenteve, që mund të shkaktonin situata të paqarta. Më tutje, theksoi se për këtë situatë nuk është vepruar *ad hoc*, siç pretendohet, por pas takimeve të shumta në mes të dikastereve kryesore të sigurisë së vendit, Kryeministrit, zëvendëskryeministrit, drejtorit të Policisë, drejtorit të AKI-së, takime me vendet e Kuintit, ka pasur takime paralajmëruese për veprimet që do të ndërmerren, për të qenë në funksion të parandalimit të provokimit dhe që mos detyrohet përdorimi i policisë, për të mos lejuar hyrjen e trenit, pasi është linjë hekurudhore e palicencuar, e paligjshme. Më tutje, shtoi se treni ka qenë një provokim i rëndë dhe konflikt-nxites, me sloganet që përmbante dhe ka qenë një bashkë-dyzim në rrafshin diplomatik, për të bindur Beogradin që është duke vepruar gabimisht dhe se gjithë kjo situatë është shoqëruar me përgatitjet e detajuara, me qëllim që mos të shkaktohen dëme.

Policia e Kosovës, ka kryer punën në mënyrë të shkëlqyer dhe se atë ditë ka qëndruar në dhomën komanduese, derisa ka përfunduar situata e krijuar, duke shtuar se planet e policisë, nuk kanë mundur të bëheshin publike dhe është mirë që të vlerësohet rezultati. Gjithashtu, theksoi se ky ishte një provokim i radhës që vjen në kontest të zhvillimeve më të gjëra, në kontest global të zhvillimit të ngjarjeve, duke shtuar se është edhe situata e kalimit të pushtetit nga një udhëheqje në tjetrën, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe situata e tillë, mund të shfrytëzohet për të krijuar situata të papërshtatshme, që mund të shërbenin si alibi nga ana e Serbisë. Në përfundim të fjalës së tij, kërkoi që të gjithë duhet të jenë të vëmendshëm, pasi katër muajt në vijim, janë të ndjeshëm dhe delikatë, që mund të prodhojnë situata të ndryshme.

**Ganimete Musliu**, përgëzoi për veprimet e shtetit të Kosovës, në të gjitha instancat, nga Presidenti deri tek qytetarët, për pjekurinë e treguar, duke shtuar se Republika e Kosovës ka dëshmuar shtetësinë, edhe pse gjithherë do të ketë provokime të tilla, por Kosova ka orientimin përëndimor dhe nuk do të ketë kthesa. Gjithashtu, vlerësoi gatishmërinë e përbashkët nga të gjitha institucionet, për të respektuar Kushtetutën, duke theksuar se mbështetja e Komisionit do të jetë gjithmonë e gatshme dhe tashmë në pozitën e zëvendëskryetares së Komisionit, do të ketë gatishmërinë për të kontribuar për vendin.

**Anton Quni**, theksoi se për rezultatin e arritur nga Policia e Kosovës, do të japë notën dhjetë, pasi performaca dhe profesionalizmi i Policisë së Kosovës ka bërë që të ndjehemi mirë, duke i treguar shtetit fqinj, që jemi komb dhe kemi kulturë shtet-formuese. Duke e ditur që në takimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, ka qenë ministri i Punëve të Brendshme, ndërsa nga mediat ka pasur informata që ka pasur ndërhyrje nga jashtë këtij institucioni se si duhet të veprohet. Më tutje kërkoi që nga ana e ministrit të shpjegohet kronologjia e ngjarjeve, si kanë qenë hapat, pasi sipas mediave Presidenti i Kosovës, z. Hashim Thaçi, pretendon se drejtpërdrejt ka dhënë urdhra. A është e saktë që ka dhënë urdhër të drejtpërdrejtë apo ekziston ndonjë e vërtetë tjetër?

**Qerim Bajrami**, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe përshëndeti aksionin e Policisë së Kosovës të ndërmarr në veri të vendit, duke shtuar që pajtohet me qëndrimin e Ministrit që nuk është e nevojshme euforia, pasi është detyrë e organeve të sigurisë që të mbrojnë kufijtë e tyre. Më tutje theksoi që sa i përket deklaratës së Presidentit serb që ” *do të ndërhyj në rast se preket ndonjë serb* ” theksoi se serbet e Kosovës nuk i prek askush dhe se janë qytetar të saj, duke shtuar që shpreson që forcat e sigurisë së Kosovës do të përcjellin gjendjen e sigurisë duke e mbrojtur komunitetin serb dhe komunitete të tjera që jetojnë në Kosovë.

Po ashtu theksoi që është e pritshme që edhe në të ardhmen mund të ketë provokime të tilla dhe në rast të incidenteve viktimat janë edhe komuniteti boshnjak që jeton atje, duke theksuar rastin e vrasjes së Shefko Salkoviq dhe Dr. Mesud Gjekoviq , të dy nga komuniteti boshnjak. Ë mbyllje të fjalës së tij, rekomandoi komunitetin boshnjak që mos të bie pre e provokimeve si dhe i bëri thirrje komunitetit serb që të integrohet në institucionet e Kosovës, pasi provokimet vijnë nga shteti serb dhe jo nga komuniteti që jeton në këtë pjesë.

**Nuredin Ibishi**, përgëzoi për aksionin e suksesshëm të Policisë së Kosovës dhe përgatitjet paraprake. Më tutje, theksoi se në çështjet operationale nuk ka përzierje të nivelit politik, duke shtuar që në të ardhmen, çështjet duhet adresuar saktë, pasi urdhrat duhet të jepen nga drejtori i Policisë, duke e vlerësuar bashkëpunimin ndër-sektorial dhe koordinimin me faktorin ndërkombëtar. Ndërsa, duke iu referuar trenit i cili tentoi të fute ilegalisht në Kosovë, theksoi që treni i tillë me ikonografi provokuese nuk ka pasur leje të futet në territorin e Kosovës.

Më tutje, theksoi se aspekti tjetër që është tentuar që t’i vishet Kosovës, gjoja është bërë “*minimi i binarëve të trenit*”, ndërkohë që në videon e publikuar, shihet qartë se binarët nuk kanë qenë të mbuluar me borë, pasi në videon e publikuar, duken ashtu, me qëllim për të akuzuar për akte terroriste, duke shtuar se policia rezervë, duhet të funksionalizohet, pra kjo pjesë e strukturës duhet të jetë funksionale, duke shtuar se sipas nenit 35 të Ligjit të policisë, parashihet mundësia e ndërhyrjes për raste të veçanta dhe përgëzoi për suksesin arritur nga Policia e Kosovës.

**Zafir Berisha**, duke iu referuar fjalës së ministrit, theksoi se kjo lë të kuptohet që në pjesën veriore veprojnë struktura kriminale dhe parashtarake. Më tutje, theksoi se ka qenë qesharake se kush e ndaloi trenin dhe shtoi se asgjë nuk është bërë më shumë, përveç se është respektuar ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, duke vlerësuar ndërhyrjet nga ana e shtetit serb, që bëhen vazhdimisht, që pas përfundimit të luftës, konsideroi se është politika e gabuar që ndiqet në raport me Serbinë dhe shtoi se qasja në bisedimet me Serbinë, në Bruksel, ka qenë e gabuar dhe nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Nga bisedimet e Brukselit, është lëshuar pe, duke u rrezikuar sovraniteti i vendit në veri, që në disa momente është menduar se mund të krijohet situata sikur në Krime të Ukrainës apo si Republika Serbe në Bosnjë. Për

këtë arsye, konsideroi që, si institucione, t'i kthehen situatës në thelb, duke mos i anashkaluar vendimet dhe marrëveshjet, pasi situata në rajon nuk është shumë e favorshme, dhe duke marrë në konsideratë këto rrethana, theksoi se duhet ndërmerren veprime, që të ruhet ajo çfarë është krijuar dhe qasja në raport duhet të jetë më ndryshe, duke theksuar provokimet e fundit që janë bërë, ndërtimi i murit në veri, si dhe arrestimi në Francë i z. Ramush Haradinaj, me urdhërarrest të Serbisë. Po ashtu, si deputet, inkurajon që shteti ynë duhet vepruar si duhet, pasi Serbia është ajo që ka qenë.

**Fatmir Shurdhaj**, theksoi se ndihet krenar për reagimin e organeve të sigurisë, veçanërisht me Policinë e Kosovës, duke shtuar se është shqetësues fakti që Marrëveshja e Kumanovës i ka mundësuar Serbisë largimin nga brezi kufitar, ndërkohë më vonë, me ardhjen e gjeneralit të ushtrisë serbe në Kosovë, me NATO-n është bërë një marrëveshje tjetër, ku i jepet mundësia ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe, që të jenë prapë afër brezit kufitar me Kosovën. Më tutje, theksoi se në brezin kufitar të Kosovës, janë vetëm policia kufitare e Kosovës, e cila mund të provokohet nga ushtria dhe xhandarmëria serbe. Sa është arritur të kontaktohet me policinë kufitare, sa janë të arriturat në këtë drejtim? A është arritur të kontaktohet për çështjen e kufirit me KFOR-in dhe EULEX-in?

Marr në konsideratë, që gati jemi në një gjendje të jashtëzakonshme, po ashtu marr në konsideratë edhe deklaratat e presidentit serb.

**Rexhep Selimi**, fillimisht theksoi se opozita kërkon dhe mbështet aksionet e Policisë së Kosovës, kurdoherë që kjo kërkohej. Më tutje, shtroi pyetjet si vijon: Duke ditur që treni, i cili ishte planifikuar të vinte, është ndaluar. Pse nuk ndalohet edhe linja e trenit Kralejë-Mitrovicë, a është ky tren i licencuar apo jo? Duke iu referuar takimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, a i është bërë pyetje Kryeministrit, pse nuk është ftuar kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së?

**Ministri i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni**, fillimisht falënderoi kryetarin për deklaratën publike, në mbështetje të veprimit të Policisë së Kosovës. Në përgjigjeje të pyetjes së z. Anton Quni, lidhur me kronologjinë e ngjarjeve, theksoi se më herët janë ndërmarrë veprime nga ana e institucioneve, para se të mblidhet Këshilli i Sigurisë së Kosovës, ndërkohë që në këtë takim është marrë vendim që të ndalohet treni, por nuk është dhënë urdhër, pasi që atë e jep drejtori i Policisë. Më tutje, konsideroi që ka pasur konsensus total dhe Presidenti ka qenë në kontakt me të gjithë aktorët e vendit, ndërsa nga ana e tij, është kërkuar nga Autoriteti Rregullator, nëse kjo linjë është e licencuar apo jo, dhe është dërguar shkresa, që kjo linjë nuk është e licencuar dhe kjo ka mjaftuar për t'u vënë në lëvizje institucionet. Ndërsa, sa i përket mospjesëmarrjes së kryetarit në takimin në Këshillin e Sigurisë të Kosovës, theksoi se do të duhej të merrte pjesë, por që nuk ka qenë as vetë në këtë takim, pasi ka pasur një delegacion. Sa i përket qytetarëve serbë, që jetojnë në Kosovë, theksoi se ata janë qytetarë të Kosovës dhe nuk kanë nevojë për deklaratat e presidentit Nikoliq, duke shtuar se qytetarët serbë duhet të kuptojnë që, për të pasur një të ardhme, duhet të orientohen nga Prishtina. Më tutje, theksoi se akti terrorist nuk ka pasur, ndërsa për videon e publikuar nuk është gjetur autori, por Policia e Kosovës ka kontrolluar atë pjesë, për të cilin është dyshuar. Ndërsa, në përgjigje të z. Zafir Berisha, theksoi se nuk është mirë që të ketë *status quo*, me shtetin serb, pasi kjo krijon stagnim, duke e konsideruar të nevojshme riformatizimin e dialogut dhe përshtatjen me rrethanat e reja. Ndërsa, sa i përket kontaktit me KFOR-in, theksoi se janë në

kontakt të vazhdueshëm, ndërsa sa i përket Marrëveshjes së Kumanovës, theksoi se gjërat kanë evoluuar, por theksoi se Policia e Kosovës duhet të mbështetet dhe të pajiset me helikopterë, dhe se këto ditë është krijuar ekipi për të punuar në këtë drejtim, kurse për këtë qëllim kërkoi përkrahjen e Komisionit.

Sa i përket gatishmërisë së Policisë së Kosovës për të rrënuar murin, theksoi se Policia e Kosovës është e gatshme, por policia nuk është kompani ndërtimi që të rrënojë, e njëjta vlen edhe për linjat hekurudhore. Pra, Policia e Kosovës nuk i bën vendimet, por kur kërkohet, mbështetja do të jepet. Në përfundim të fjalës së tij, theksoi se për çdo veprim sigurohet që të jetë në koordinim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës, duke dëshmuar pjekurinë institucionale.

**Kryetari**, falënderoi ministrin për këtë raportim dhe aksionin e kryer, si dhe falënderoi për gjetjen e zgjidhjes për objektin e stacionit policor, numër katër në Prishtinë. Me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështes i Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

---

**Daut Haradinaj**